



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

TRANSKRIPT
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 13 MARS
2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE 13 MARTA
2008.GODINE

MARS – MART
2008

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i grupit të dytë të projektligjeve nga Propozimi i Marti Ahtissarit:
 - 1.1 Projektligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës,
 - 1.2 Projektligji për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës,
 - 1.3 Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës,
 - 1.4 Projektligji për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës,
 - 1.5 Projektligji për të drejtat komuniteteve dhe pjesëtarët e tyre,
 - 1.6 Projektligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë i vitit 2008,
 - 1.7 Projektligji për financat e Pushtetit Lokal,
 - 1.8 Projektligji për Aviacionin Civil,
 - 1.9 Projektligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe
 - 1.10 Projektligji për kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

Dnevni red:

1. Drugo razmatranje druge grupe nacarta zakona iz Predloga Marti Ahtisarija:
 - 1.1. Nacrt zakona o Ministarstvu spoljnih poslova i diplomatskoj službi Republike Kosova,
 - 1.2. Nacrt zakona o Ministarstvu Odbrambenih snaga Kosova,
 - 1.3. Nacrt zakona o Bezbedonosnim snagama Kosova,
 - 1.4. Nacrt zakona o osnivanju Bezbedonosnog saveta Kosova,
 - 1.5. Nacrt zakona o pravima zajednica i njenih pripadnika,
 - 1.6. Nacrt zakona o upravljanju javnim finansijama i odgovornostima iz 2008. godine,
 - 1.7. Nacrt zakona o finansijama lokalne vlasti,
 - 1.8. Nacrt zakona o civilnoj avijaciji,
 - 1.9. Nacrt zakona o Specijalnom tužilaštvu Republike Kosova, i
 - 1.10. Nacrt zakona o nadležnostima, selekciji i određivanju predmeta sudija i tužilaca EULEX-a na Kosovu.

Agenda:

1. Second reading of the Draft Laws from the Marti Ahtisaari's proposal:
 - 1.1 Draft Law on Ministry of Foreign Affairs and Diplomatic Service of Republic of Kosovo,
 - 1.2 Draft Law on the Ministry of Security Forces of Kosovo,
 - 1.3 Draft Law on Security Forces of Kosovo,
 - 1.4 Draft Law on establishing the Security Council of Kosovo,
 - 1.5 Draft Law on the Rights of Communities and their members,
 - 1.6 Draft Law on Managing Public Finances and Responsibilities for year 2008,
 - 1.7 Draft Law on Finances of Local Government,
 - 1.8 Draft Law on Civil Aviation,
 - 1.9 Draft Law on Special Prosecution of Republic of Kosovo, and
 - 1.10 Draft Law on competencies, selection and appointment of the files to the judges and EULEX prosecutors in Kosovo.

TRANSKRIPT
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 13 MARS
2008

Mbledhja filloi punën në orën 14:00

Mbledhjen e drejtoi Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI I KUVENDIT JAKUP KRASNIQI:

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

I nderuari zëvendëskryeministër,

Mirë se erdhët në punën e Seancës së sotme plenare të Kuvendit të Kosovës.

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 70 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Po ashtu, ju njoftoj se, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin e ndërlidhur me procedurë të veçantë, në seancën e sotme plenare do të procedohen për leximin e dytë projektligjet, të miratuara dje në leximin e parë.

Po ashtu, ju njoftoj se Komisioni ad-hoc i ka shqyrtuar projektligjet dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin, me rekomandime.

Raporti i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve, prandaj do të fillojmë me procedim të mëtejshëm.

Ftoj zotin Fehmi Mujota, që në emër të Komisionit ad-hoc, t'i arsyetojë rekomandimet për të gjitha projektligjet e shqyrtuara.

Para se ta marrë fjalën deputeti Fehmi Mujota, ju njoftoj se tani në sallë janë të pranishëm 96 deputetë.

FEHMI MUJOTA: I nderuari Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra të Kabinetit të Qeverisë së Kosovës,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Komisioni ad-hoc, në bazë të pikës 3 të Vendimit të Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin e ndërlidhur me të, sipas procedurës së veçantë, të datës 15 shkurt 2008, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2008, ka shqyrtuar projektligjet e pakos së dytë të ardhur në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga Propozimi i Ahtisarit.

Komisioni, po ashtu, në bazë të pikës 3 të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ka siguruar pajtueshmërinë e brendshme të projektligjeve dhe harmonizimin gjuhësor. Andaj, propozimet dhe ndryshimet përmbajtjesore mund të bëhen vetëm nëse konsiderohen të nevojshme nga Komisioni ad-hoc.

Komisioni, gjatë ditës së djeshme i ka shqyrtuar projektligjet e grupit të dytë nga Propozimi i Ahtisarit dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, të cilat iu janë shpërndarë deputetëve dhe ato kanë të bëjnë me:

- Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës;
- Projektligjin për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës;
- Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Republikës së Kosovës;
- Projektligjin për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- Projektligjin për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;
- Projektligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të vitit 2008,
- Projektligjin për financat e pushtetit lokal,
- Projektligjin për Aviacionin Civil të Kosovës,
- Projektligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe
- Projektligjin për kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

Prandaj, të nderuar deputetë, më lejoni që në fillim të këtij prezantimi të raportit para jush, të vlerësojë dhe të falënderoj për punën e pandërprerë të Komisionit ad-hoc të cilën e përbëjnë të gjitha grupet parlamentare dhe njëkohësisht të falënderoj grupet punuese që paraprakisht kanë punuar në hartimin e këtyre ligjeve në përputhshmëri me Pakon e Ahtisarit dhe Projektkushtetutën e Republikës së Kosovës.

Një falënderim të veçantë dua t'ua drejtoj deputetëve, të cilët, në mënyrë individuale janë përpjekur të ofrojnë rekomandime dhe të ofrojnë amendamente për Komisionin ad-hoc, për të cilat, nga ndonjë arsye të caktuar ose për ndonjë vonesë të caktuar - nuk kanë arritur të futen në raportin tonë, përkatësisht në ndryshimet që janë sjellë para jush.

Vlerësoj se Komisioni, arsyetimet që i ka bërë para jush, i ka bazuar kryesisht në arsyetimet që i kanë bërë Kryeministri i Kosovës dhe ministrat e Qeverisë së Kosovës për secilin ligj veç e veç dhe në përputhshmëri e pajtueshmëri me Pakon e Ahtisarit dhe Projektkushtetutën e Republikës së Kosovës.

Vlerësojmë se Komisioni ad-hoc duhet të bëjë të qartë para Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe para opinionit se nuk është Komisioni që i harton këto ligje, por është Komisioni i cili ka marrë një mandat të caktuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për të bërë amendimin dhe plotësimet e caktuara, për aq sa është e lejuar, brenda kësaj fuqie që na ka dhënë Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Këtë e them me arsye, sepse, jo rrallë herë, ka ndodhur që edhe në mediat të quhet si komision për hartimin e këtyre ligjeve që, në fakt, nuk është një gjë e tillë, por është Komision ad-hoc në mandatin e vet.

Jemi shumë të bindur se në këto 15 ndryshime, që i keni para vetes, kemi të bëjmë me ndryshime jopërmbytësore dhe kemi të bëjmë kryesisht me ndryshime që rregullojnë pajtueshmërinë gjuhësore në mes të ligjeve dhe, natyrisht, edhe bëjnë një lloj rregullimi ose strukturimi gjuhësor, edhe pse jemi shumë të vetëdijshëm se lektorët në Kuvendin e Republikës së Kosovës do të kenë shumë punë për të harmonizuar dhe për të rregulluar ashtu si duhet gjuhësisht të gjithë tekstet e këtyre ligjeve që kemi para vetes.

Në punën tonë, si Komision ad-hoc, kemi pasur edhe rastin të votojmë për amendamente e natyrisht edhe për ndryshime dhe në të gjitha rastet kemi pasur pajtueshmëri të plotë, me përjashtim të dy propozimeve. Në njërin kemi pasur rast që të mos kemi vendimin e dy të tretave të Komisionit ad-hoc kur kemi pasur një amendament nga Grupi Parlamentar "7+", për të cilin Komisioni e ka dhënë vlerësimin e vet dhe në bazë të autoritetit të vet ka vendosur për këtë gjë, dhe mbi bazë të shpjegimeve që janë dhënë dje në Seancën plenare nga zëvendëskryeministri i Kosovës.

Prandaj, për çështje të tilla, besoj se do të kemi mundësi sqarimi dhe mundësi të hapjes së perspektivës së këtyre çështjeve në të ardhmen edhe me format tjera në Qeverinë e Kosovës dhe në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

Gjatë punës së Komisionit ad-hoc kemi pasur ndihmesë, sugjerime, por natyrisht edhe përkrahje të madhe edhe nga përfaqësuesit civil ndërkombëtar dhe nga përfaqësuesi i Zyrës, përkatësisht nga përfaqësuesi i Ambasadës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilët i falënderojmë për kontributin e tyre.

Andaj, të nderuar kolegë, në fund mund të them që këto propozime, të cilat janë propozime të Komisionit ad-hoc, shpresojmë se mund të jenë edhe propozime tuaja dhe aprovim i juaj. Dhe, jemi shumë të bindur, që secili nga ju do të kishte një mendim pak më ndryshe për çështje të caktuara, sikur që edhe ne kishim mendimin tonë, por tani bashkërisht do të kemi të njëjtin mendim për t'i aprovuar, në tërësi, këto ndryshime. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, do të duhej ta merrnin fjalën kryetarët e grupeve parlamentare, por nuk është paraqitur asnjë. Tani po shoh se u lajmëruan. Dhe, menjëherë, ia japim fjalën kryetarit të Grupit Parlamentare të Partisë Demokratike, Ramë Buja. Urdhëroni, zoti Buja.

RAMË BUJA: I nderuari zoti kryetar,
I respektuar Kabinet qeveritar,
Të çmuar kolegë deputetë,

Dje ne e dhamë një tumirje, në parim, të këtyre ligjeve edhe me votën e këtij Parlamenti dhe, natyrisht, nuk kemi gjë për të ndryshuar. Andaj, edhe në bazë të një raportimi që na është bërë nga anëtarët e Komisionit ad-hoc, të cilët janë nga radhët tona, ne si Grup Parlamentar e aprovojmë në tërësi këtë pjesë të pakos së ligjeve të Ahtisarit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari Kryeministër,
Kolegë të nderuar,

Grupi Parlamentar i LDK-së mbështet Raportin që u paraqit nga kolegu Fehmi Mujota, në emër të Komisionit ad-hoc.

Mirëpo, meqë ka ndodhur një lëshim teknik, që sigurisht është pjesë e gabimit teknik - të shtypit, që ka të bëjë me Projektligjin për financat e pushtetit lokal, në amendamentin 2, ku thuhet: “Komisioni gjatë shqyrtimit të Projektligjit për financat e pushtetit lokal, konstatoi se në shtojcën e Projektligjit lidhur me të dhënat për ndarjen e granteve të përgjithshme në komunat: Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq” e jo Graçanicë.

Do të duhej pra “Leposaviq”, që është fjala për tri komunat, në të cilat ne nuk kemi pasur pasqyrim. Kemi kërkuar që dy ministritë përgjegjëse, ajo e pushtetit lokal dhe e financave ta dërgojnë aneksin e ri dhe i kemi marrë të dhënat e reja, që i është bashkëngjitur ky dokument. Do të thotë, e kemi fjalën vetëm për korrektësi, sepse është fjala, do të thotë, për Leposaviq, e jo për Graçanicë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Domethënë, emri “Graçanicë”, aty ku është, duhet të zëvendësohet me emrin “Leposaviq”? Ju faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Grupit të AKR-së, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti Kryeministër,
Të nderuar ministra, kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re mbështet raportin e kryetarit të Komisionit ad-hoc, zotit Mujota, dhe e jep mbështetjen për votim të këtyre ligjeve që dalin si pjesë e dytë e Pakos së Ahtisarit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka kryetari i Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, sikur grupet e tjera parlamentare, i mbështet të gjitha ligjet, të cilat i kemi kaluar dje dhe të cilat janë shqyrtuar në Komisionin ad-hoc. Ju faleminderit!

KRYTARI: Ju faleminderit!

Lutfi, sipas shenjës që kam, e ke kërkuar fjalën? Nëse jo, shtype tastin dhe shkyçu, sepse te unë po regjistrohet se e ke kërkuar fjalën.

A dëshiron ndokush tjetër të paraqitet për fjalë?

Meqenëse nuk ka të paraqitur tjerë për fjalë, vazhdojmë me amendamentet.

Për **Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës** kemi amendamente, si vijon.

Ju njoftoj se në sallë janë 103 deputetë.

Amendamenti 1.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se 91 deputetë kanë votuar “për”, 2 “kundër” dhe 1 abstenim, andaj miratohet amendamenti.

Amendamenti 2.

Lus deputetët dhe regjinë le të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Faleminderit! Miratohet amendamenti me 96 vota “për”, 2 “kundër” dhe 1 abstenim.

Vazhdojmë me **Projektligjin për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës**. Për këtë Projektligj nuk ka amendamente të propozuara..

Vazhdojmë më tutje, me pikën e tretë:

- **Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës**, i cili ka dy amendamente.

Amendamenti 1.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 93 vota “për”, 3 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Lus deputetët dhe regjinë le të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Miratohet edhe amendamenti 2 me 90 vota “për”, 5 “kundër” dhe 5 abstenime.

Në radhë është amendamenti 3.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për të votuar. Votojmë tash:

Konstatohet se miratohet amendamenti 3 me 91 votë “për”, 2 “kundër” dhe 2 abstenime.

Në radhë është pika e katërt:

- **Projektligji për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës**.

I kemi dy amendamente.

Votojmë për amendamentin 1.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 83 vota “për”, 2 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Në radhë është amendamenti 2.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me vota 95 “për”, 2 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Në radhë është pika e pestë e rendit të ditës:

- Projektligji për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Për këtë Projektligj i kemi 5 amendamente.

Shkojmë me amendamentin 1.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 95 vota “për”, 3 “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 95 vota “për”, 2 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Ftoj deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 97 vota “për”, 2 “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 97 vota “për”, 2 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Ftoj deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 99 vota “për”, 2 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 5.

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

- Projektligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të vitit 2008.

Në këtë Projektligj është paraqitur vetëm një amendament.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 96 vota “për”, 6 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet ky amendament.

Në radhë është pika e shtatë e rendit të ditës:

- Projektligji për financat e pushtetit lokal.

Këtu kemi një propozim për ndryshim, i paraqitur nga deputeti Lutfi Haziri.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 89 vota “për”, 4 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet propozimi për ndryshim, i paraqitur nga deputeti Haziri.

Amendamente të tjera për këtë Projektligj, nuk ka pasur.

Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

- Projektligji për Aviacionin Civil të Kosovës.

Edhe për këtë Projektligj nuk ka amendamente.

Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

- Projektligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

Për këtë Projektligj janë paraqitur dy amendamente.

Amendamenti 1.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 93 vota “për”, 2 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 91 votë “për”, 2 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës:

- Projektligji për kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

Ky Projektligj ka dy amendamente.

Amendamenti 1.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me 90 vota “për”, 4 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Me 88 vota “për”, 4 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Të nderuar deputetë,

Duke u bazuar në procedurat e veçanta për shqyrtimin dhe miratimin e këtyre ligjeve, kërkoj nga ju që me anë të votimit, të deklaroheni për miratimin e projektligjeve në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim të të gjitha këtyre projektligjeve, me amendamente. Votojmë tash:

Konstatoj se me 83 vota “për”, 7 “kundër” dhe 5 abstenime, u miratuan këto ligje:

1. Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës;
2. Ligji për Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës;
3. Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
4. Ligji për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
5. Ligji për të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre;
6. Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të vitit 2008;
7. Ligji për financat e pushtetit lokal;
8. Ligji për Aviacionin Civil të Kosovës;
9. Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe
10. Ligji për kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Republikën e Kosovës.

Me kaq, përfundojmë seancën e sotme.

Mirupafshim, në seancën e nesërme, në orën 10.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës